



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority

Vendimi Nr.82/24
Datë: 16.09.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023 Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkates. Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit, në mbledhjen e datës 16.09.2024, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET. Përqendrim i ndërmarrjeve lidhur me marrjen e kontrollit vetëm nga Euromedia Group a.s., mbi kompaninë e synuar PEMIC BOOKS a.s.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 05.08.2024, me Nr. Prot. 497/24-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me marrjen e kontrollit të vetëm nga Euromedia Group a.s., mbi kompaninë e synuar PEMIC BOOKS A.S.

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 22.08.2024
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 26.08.2024
3. Transaksioni bazohet në Marrëveshjen për Shitblerje të Aksioneve të lidhur mes palëve me datë 30 qershor 2024.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
3. Transaksioni bazohet në Marrëveshjen për Shitblerje të Aksioneve të lidhur mes palëve me datë 30 qershor 2024.

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim, i paraqitur në bazë të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe bazuar në nenet 11,13,17,18 si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2023 neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve Sekretariati ka filluar vlerësimin e kërkesës për Përqendrim.

Palët në transaksion:

Euromedia Group a.s., shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Çekisë, me seli në adresën: Nádražní 762/32, Smíchov ,150 00 Prague 5, Republika Çeke, e regjistruar në regjistrin tregtar të Çekisë me numër të biznesit: 497 09 895, e cila merret me botim librash, shitje librash me shumicë dhe pakicë. Euromedia Group a.s., është një kompani që i përket një grupi biznesi të kontrolluar përfundimisht nga (" JH ") (" Grupi JH "), me bazë në Çeki. Në tregun Republikës së Kosovës z. Jakub Havrlant (" JH ") ushtron kontroll të përbashkët mbi Gjirafën me dy palë të tjera të përbashkëta kontrolluese;

Grupi Gjirafa, operon një motor kërkimi në gjuhen shqipe, një platformë për përmbajtje video/lajme, një platforme marketingu online dhe një platformë e-commerce të fokusuar në Shqipëri, Republikën e Kosovës dhe Maqedoninë e Veriut. Grupit Grupi Gjirafa ka filialet e mëposhtme në Kosovë:

- **Gjirafa Kosovë Sh.p.k.**, me numër unik identifikimi 810123860;
- **Gjirafa , Inc - Dega në Kosovë** , me numër unik identifikimi 810840307; dhe
- **Trekandi Sh.p.k.**, me numër unik identifikimi 810046757.

Së fundi Gjirafa Inc së bashku me Carvago Holding a.s., kanë krijuar ndërmarrjen e përbashkët **Carvago by Girafa** e cila do t'u ofroje konsumatorëve kosovar blerjen dhe shitjen e veturave të përdorura tërësisht online. Platforma vepron një treg makinash në internet dhe do të bëjë të disponoheshë për blerjen e makinave nga e gjithë Evropa për klientët individual dhe të biznesit.

PEMIC BOOKS a.s., shoqëri aksionare me numri i biznesit: 258 99 881, me adresa të regjistruar në: Smetanovo náměstí 222/8, Moravská Ostrava, 02 00 Ostrava , Republika Çeke, e cila merret me botim librash, shitje librash me shumicë, pakicë, transport dhe logjistikë magazinimi. PEMIC është aktiv (vetëm ose nëpërmjet filialeve të saj) në fushat e mëposhtme: shtëpi botuese librash, shitje me shumicë dhe pakicë të librave dhe mallrave që korrespondojnë me asortimentin plotësues jo-libër, transportet dhe logjistikën e magazinës. PEMIC nuk është prezent në asnjë mënyre në Kosovë.

Tregu Relevant;

Tregu i produktit: Tregu i botimeve të librave, shitje librash me shumicë dhe pakicë.

Tregu gjeografik: Elementi gjeografik i tregut, mund të përcaktohet si ndërkombëtar me theks të veçantë Republika Çeke.

Analiza e konkurrencës:

Pas analizave në tregut përkatës, duke parë që targeti nuk ka shtrirje të aktiviteteve në Kosovë dhe aktualisht nuk ka synime specifike për të investuar ose transferuar njohuri para ose pas përqendrimit në tregun, ndërmarrja aktivitetin e saj do ta shtrijë në vendet ku tashme është prezent. Pra duke u nisur nga fakti që targeti nuk është në asnjë formë aktiv në Kosovë, nuk mund të ketë mbivendosje horizontale apo marrëdhënie vertikale ndërmjet palëve në përqendrim në tregun e Kosovës. Blerësi synon që përmes këtij transaksionit do të mundësoje ndërmarrjes shfrytëzimin e ekonomive të shkallës dhe efijencës që rrjedhin nga investimi i vazhdueshëm në automatizim dhe inovacione të tjera. Në këtë kontekst, blerja do të siguroje qëndrueshmërinë dhe konkurrencën afatgjate të biznesit të tij në segmentin e librit, veçanërisht në nivelin e shitjes me shumicë, në kuadër të presionit të konsiderueshëm konkurrues nga konkurrentet në internet dhe të tregtisë elektronike, si dhe kërkesave përgjithësisht në rritje. mbi cilësinë dhe standardet e shërbimeve të ofruara. Krahas kësaj, transaksioni do të kontribuojë me pas në funksionimin e qëndrueshëm dhe afatgjate të tregut të librave në Republikën Çeke mbi bazën e qasjes se barabarte dhe jo diskriminuese me një çmim konkurrues për të gjithë konkurrentët në fushën e librit Transaksioni i propozuar nuk do të ndikoj në tregun e Republikës së Kosovës dhe si i tillë nuk ngrit shqetësimin për konkurrencën dhe as konsumatorët në Republikën e Kosovës.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Çekisë, kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se Aplikuesi (Euromedia Group a.s.) është kompani që i përket Grupi JH, të kontrolluar përfundimisht nga z. Jakub Havrlant e pjesë e secilës edhe Grupi Gjirafa. Grupit Gjirafa kontrollohet bashkërisht nga z. JH dhe dy palë të tjera të përbashkëta kontrolluese. Gjirafa Group ka filiale të regjistruar në Republikën e Kosovës. Sipas vlerësimit të përqendrimit nga ky transaksion, nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës, për arsye se targeti nuk është prezent në tregun përkatës të Republikën e Kosovës, qoftë përmes personit juridik ose nëpërmjet shitjeve dhe si i tillë nuk ka mundësi të bëjë ndryshim në strukturën (horizontale apo vertikale) të tregut, sa i përket mbivendosjeve të mundshme horizontale, përqendrimin i propozuar nuk implikon mbivendosje të konsiderueshme horizontale, palët nuk planifikojnë as në të ardhmen të shtrijë aktivitetin

e saj në Kosovës. Ndërmarrjet e përfshira në Përqendrim nuk kanë ndikim në tregun kosovar e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg.

Autoriteti ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga “Njoftimi” nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

AUTORITETI I KONKURRENCËS KOMISIONI



Neime Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva